

# Platforma për të Drejtat e Njeriut

## Goal: SHËNDET I MIRË DHE MIRËQENIE

Sigurimi i jetës së shëndetshme dhe nxitja e mirëqenies për të gjithë njerëzit e çdo moshe.

### Target: 3.5

Të forcohet parandalimi dhe trajtimi i personave që abuzojnë me me lëndët narkotike dhe alkoolin.

<b>Instrumentet ndërkombëtare</b>	<b>Nenet</b>
Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas	Neni 12.2
Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas	<b>12.2</b> Pavarësisht nga dispozitat e paragrafit I të këtij neni, Shtetet Palë do t'u sigurojnë grave shërbime të përshtatshme në lidhje me shtatzaninë, lindjen dhe periudhën pas lindjes, duke u dhënë shërbime falas, aty ku është e nevojshme, si dhe ushqim adekuat gjatë shtatëzansisë dhe laktacionit.
Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas	Neni 21.1
Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas	21.1 Secili ka të drejtë të marrë pjesë në qeverinë e vendit të tij, drejtpërdrejt ose përmes përfaqësuesve të zgjedhur lirshëm
Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas	Neni 21.2
Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas	21.2 Gjithkush ka të drejtë të ketë qasje të barabartë në shërbimin publik në vendin e tij.
Pakti Nderkombëtar për të Drejtat civile dhe Politike	Article 6.1
Pakti Nderkombëtar për të Drejtat civile dhe Politike	E drejta e jetës së shëndetshme dhe e mirëqenies së njeriut. Kjo e drejtë duhet të mbrohet me ligj. Askush nuk mund të privohet arbitrarisht nga jeta.

**Instrumentet  
ndërkombëtare**

**Nenet**

Deklarata Universale për  
të Drejtat e Njeriut

Neni 3

Deklarata Universale për  
të Drejtat e Njeriut

Gjithkush ka të drejtën për jetën, lirinë dhe sigurinë e personalitetit.

Neni 25 para 1

Deklarata Universale për  
të Drejtat e Njeriut

1. Gjithkush ka të drejtë për një nivel jetese të mjaftueshëm i cili t'i përgjigjet shëndetit dhe jetës së përshtatshme si të atij personalisht, ashtu edhe të familjes së tij, duke përfshirë ushqimin, veshmbathjen, banesën, kujdesin mjekësor dhe shërbimet e nevojshme sociale, si edhe të drejtën për të qenë i siguruar në rast sëmundjeje, papunësie, vejanie, pleqërie dhe raste të tjera të humbjeve të mjeteve për jetesë për shkak të rrethanave të pavarura nga vullneti i tij.

Deklarata Universale për  
të Drejtat e Njeriut

Neni 33

Konventa për të Drejtat e  
Fëmijës

Shtetet Palë marrin të gjitha masat e duhura, duke përfshirë ato legjislative, administrative, shoqërore dhe edukative, për të mbrojtur fëmijët nga përdorimi ipaligjshëm i drogave narkotike dhe lëndëve psikotrope, siç përcaktohen nëkonventat përkatëse ndërkombëtare dhe për të mos lejuar që fëmijët të përdoren për prodhimin dhe trafikun e paligjshëm të këtyre lëndëve.

Konventa për të Drejtat e  
Fëmijës

**Ligjet**

**Nenet**

Neni 1

Neni 1 Qëllimi i Ligjit

LIGJI NR. 02/L-128

PËR BARNAT  
NARKOTIKE,  
SUBSTANCAT  
PSIKOTROPE DHE  
PREKURSORË

a) Ligji rregullon prodhimin, qarkullimin me shumicë dhe pakicë, importin, eksportin, kalimin transit, transportin, blerjen, furnizimin, shitjen, posedimin, konsumimin, përdorimin dhe propagandimin e bimëve prej të cilave mund të përfitohen narkotikët, barnat narkotike, substancat psikotrope dhe prekursorët. b) Përcakton obligimet e autoriteteve kompetente të cilat kanë lidhshmëri me këto substanca; c) Bënë klasifikimin e bimëve, barnave narkotike, substancave psikotrope dhe prekursorëve në bazë të rrezikshmërisë së tyre, gjatë përdorimit në mjekësi dhe veterinarë; d) Përcakton masat e përgjithshme për parandalimin dhe luftimin e keqpërdorimit të bimëve, barnave narkotike, substancave psikotrope dhe prekursorëve; e) Përcakton masat ndëshkimore në rast të shkeljeve së dispozitave të këtij ligji, dhe akteve normative në bazë të këtij ligji.

LIGJI NR. 02/L-128

PËR BARNAT  
NARKOTIKE,  
SUBSTANCAT  
PSIKOTROPE DHE  
PREKURSORË

## Ligjet

## Nenet

Neni 32

Neni 32 Parandalimi i përhapjes së sëmundjeve të varësisë

LIGJI NR. 02/L-128  
PËR BARNAT  
NARKOTIKE,  
SUBSTANCAT  
PSIKOTROPE DHE  
PREKURSORË  
LIGJI NR. 02/L-128  
PËR BARNAT  
NARKOTIKE,  
SUBSTANCAT  
PSIKOTROPE DHE  
PREKURSORË

32.1 Mënyrat e parandalimit të përdorimit ilegal të barnave narkotike dhe substancave psikotrope si dhe përhapjes së sëmundjeve të varësisë, përcaktohen me Planin strategjik nga neni 6.3, paragrafi (d) i këtij Ligji, të miratuar nga Qeveria me propozim të Komisionit për narkotik. 32.2 Qeveria e Kosovës dhe qeveritë lokale, përkrahin aktivitetet e institucioneve shëndetësore dhe jo shëndetësore, asociacionet jo-profitabile dhe fondacionet që luftojnë përhapjen e sëmundjeve të varësisë. 32.3 Ministria e Shëndetësisë obligon Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës (më tutje, IKSHPK) të bëj mbledhjen e të dhënave për shfrytëzuesit dhe keqpërdoruesit e barnave narkotike dhe substancave psikotrope, analizën epidemiologjike të gjendjes; koordinimin me institucione dhe punëtorë shëndetësorë dhe jo shëndetësorë, si dhe realizimin e promovimit dhe edukimit shëndetësorë për parandalimin e përhapjes së sëmundjeve të varësisë. 32.4 Me qëllim të parandalimit të sëmundjeve të varësisë obligohet personi juridik, personi përgjegjës i personit juridik dhe personat e tjerë fizikë gjatë kryerjes së rregullt të detyrave të punës, që në rast të dyshimit për keqpërdorim të bimëve, narkotikëve dhe prekursorëve nga Tabela I, II, III dhe IV menjëherë ta lajmërojnë rastin në Shërbimin Policor të Kosovës.

LIGJI NR. 02/L-128  
PËR BARNAT  
NARKOTIKE,  
SUBSTANCAT  
PSIKOTROPE DHE  
PREKURSORË  
LIGJI NR. 02/L-128  
PËR BARNAT  
NARKOTIKE,  
SUBSTANCAT  
PSIKOTROPE DHE  
PREKURSORË

Neni 34

Neni 34

Rehabilitimi i sëmundjeve të varësisë Rehabilitimi psikosocial i personave që vuajnë nga sëmundjet e varësisë organizohet nga Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Ministria e Punëve të Brendshme dhe Ministria e Kulturës, Rinisë, Sportit dhe çështjeve jo rezidente.

Neni 33

LIGJI NR. 02/L-128  
PËR BARNAT  
NARKOTIKE,  
SUBSTANCAT  
PSIKOTROPE DHE  
PREKURSORË  
LIGJI NR. 02/L-128  
PËR BARNAT  
NARKOTIKE,  
SUBSTANCAT  
PSIKOTROPE DHE  
PREKURSORË

Neni 33 Trajtimi i sëmundjes së varësisë

33.1 Sëmundjet e varësisë trajtohen në bazë të vullnetit të lirë të personit ose të kujdestarit ligjor, apo në bazë të vendimit të gjykatës, në pajtim me ligjin. 33.2 Sëmundjet e varësisë trajtohen në të gjitha institucionet e licencuara shëndetësore. 33.3 Koordinimin dhe zhvillimin e shërbimeve për sëmundje të varësisë si dhe trajtimin e tyre, multidisiplinar e bënë Instituti për sëmundje të varësisë si qendër referente e nivelit tretësor të kujdesit shëndetësor për sëmundje të varësisë, që themelohet nga Qeveria e Kosovës. 33.4 Institucionet të cilat mirren me identifikimin, trajtimin dhe rehabilitimin e sëmundjeve të varësisë, janë të obliguara që t'i paraqesin të dhënat për rastet në IKSHPK.

**Ligjet****Nenet**

## Neni 3

LIGJI NR. 02/L-128  
PËR BARNAT  
NARKOTIKE,  
SUBSTANCAT  
PSIKOTROPE DHE  
PREKURSORE  
LIGJI NR. 02/L-128  
PËR BARNAT  
NARKOTIKE,  
SUBSTANCAT  
PSIKOTROPE DHE  
PREKURSORE

Neni 3 Kufizimet e veprimtarisë me narkotikë

3.1 Ndalohet çdo lloj veprimtarie me bimët dhe narkotikët nga Tabela I e këtij ligji, përveç për qëllime të hulumtimeve shkencore, edukative dhe policore. 3.2 Ndalohet kultivimi i bimëve nga të cilat mund të përfitohen narkotikët. 3.3. Ndalohet çdo lloj veprimtarie me bimë, barna narkotike dhe substanca psikotrope të cilat i takojnë Tabelës II, III dhe me prekursorë nga Tabela IV e këtij ligji, përveç për qëllime mjekësore, veterinare, shkencore, edukative, mjeko-ligjore dhe policore. 3.4 Ndalohet posedimi i pajisjeve për përpunimin e narkotikëve përveç personave juridik të cilët posedojnë licencë për prodhim të barnave narkotike dhe substancave psikotrope. 3.5 Ndalohet propaganda me qëllim promovimit të prodhimit ilegal, shites, qarkullimit, importit, eksportit, transportit, blerjes, furnizimit, posedimit ose shfrytëzimit të barnave narkotike, substancave psikotrope dhe prekursorëve.